



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 21.11.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 21 nëntor 2019, ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “**Për Buxhetin e vitit 2020**” *në parim*.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Znj.Anila Denaj, Ministre, Ministria për Ekonomine dhe Financat

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2020*” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve) për vitin buxhetor 2020.

Projektbuxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritit në Bashkimin European.

Projektbuxheti 2020 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. **Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore**, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. Në shpenzimet e personelit për vitin 2020, është parashikuar edhe kostoja për mbështetjen e institucioneve të krijuara në zbatim të reformës në drejtësi. **Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2020 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integritit european.**

Prioriteti i Qeverisë Shqiptare për vitin 2020 vazhdon të jetë hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integritit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2020, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së **Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)** për realizimin e këtij objekti si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive për procesin e negociatave.

1. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2019-2021

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2019-2021, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë të Shteteve Anëtare të BE-së.

2. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

Legjislacioni parësor i BE-së

- *Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Nenet 313-316 dhe 320-324.*

Legjislacioni dytësor i BE-së

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012”.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja (BE), Nr.2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

3. Përfundime

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” nuk përfron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Komisioni miratoi **në parim** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 06.12.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në 06 dhjetor 2019, ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “**Për Buxhetin e vitit 2020**” *nen për nen*.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Z. Etjen Xhafaj, Zëvendës Ministër, Ministria për Europen dhe Punët e Jashtme

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2020*” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve) për vitin buxhetor 2020.

Projektbuxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritit në Bashkimin European.

Projektbuxheti 2020 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. **Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore**, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre. Në shpenzimet e personelit për vitin 2020, është parashikuar edhe kostoja për mbështetjen e institucioneve të krijuara në zbatim të reformës në drejtësi. **Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2020 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integritit european.**

Prioriteti i Qeverisë Shqiptare për vitin 2020 vazhdon të jetë hapja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integritit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2020, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së **Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)** për realizimin e këtij objekti si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive për procesin e negociatave.

4. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2019-2021

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2019-2021, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë të Shteteve Anëtare të BE-së.

5. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

Legjislacioni parësor i BE-së

- *Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Nenet 313-316 dhe 320-324.*

Legjislacioni dytësor i BE-së

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “*Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012*”.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja (BE), Nr.2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

6. Përfundime

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2020*” nuk përfron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Komisioni miratoi **nen për nen** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI